

KONCESIONE

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT **FTESA PER OFERTE**

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit e Republikës së Shqipërisë (në vijim e referuar si Autoriteti Kontraktues), mbështetur në ligjin nr. 9663, datë 18/12/2006 “Per konçesionet” i ndryshuar, VKM-në nr. 27, datë 19/01/2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së konçesioneve”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 172, datë 10/03/2010, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënien me Konçesion per dhenien me koncesion të disa shërbimeve detare dhe miratimin e Bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurrese, që i jepet shoqërisë “Anijet e Shërbimit Detar” sh.a,”i ndryshuar, fton investitorë të interesuar vendas dhe/ose të huaj të marrin pjesë në procedurat konkurrese përzgjedhëse për dhënien me konçesion të këtyre shërbimeve detare:

- a) Kryerja e shërbimit të rimorkimit të anijeve gjatë operacionit të futjes e daljes nëpër porte, akostimit në kalatat e porteve;**
- b) Shërbimi i transportit të grupeve të praktikës së autoriteteve portuale gjatë marrjes së praktikave të lira në rada;**
- c) Transportimi i ekipazheve të anijeve nga rada në port dhe anasjelltas;**
- d) Operacionet e ngarkim-shkarkimit të peshave të rënda në det”.**

Ofertuesit e interesuar mund të njihen me dokumentat standarde të procedurës konkurrese pranë Sektorit të Trajtimit të Konçesioneve, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit. Një kopje e plotë e këtyre dokumenteve mund të sigurohet nga çdo i interesuar pranë Sektorit të Trajtimit të Konçesioneve në MPPT, kundrejt pagesës së një tarife të pakthyeshme prej 30.000 Lekë. Kjo tarifë do të derdhet pranë Bankës Kombëtare Tregëtare në numrin e llogarisë bankare 401279588 (Të ardhurat e Thesarit, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit) (nr. iban AL4720511014279588CLTJCLALLA) Shqipëri, pasi të jetë tërhequr një formular tip, pranë Sektorit të Trajtimit të Konçesioneve në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

Dokumentat Standarte të Procedurës Konkurrese do të merren pranë Sektorit të Trajtimit të Konçesioneve në adresën, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Sheshi Skënderbej nr. 3, Tiranë, Shqipëri.

Per me shume informacion

www.app.gov.al

Të dhënat e kontaktit: Tel.: 00355 4 2380 767;
Personi i kontaktit: Znj. Eneida Marku;
E-mail: eneida.marku@mppt.gov.al;

Ofertat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor jo më vonë se data 24.02 .2011, ora 12.00 dhe do të hapen menjëherë pas kalimit të këtij afati në prani të përfaqësueve të ofertuesve të cilët janë të ftuar të ndjekin zhvillimin e procedurës konkurruese.

Asnjë ofertë e paraqitur pas këtij afati nuk do të pranohet.

Ofertuesit duhet të angazhohen se pranojnë kushtet e percaktuara ne ftesen per proçedurë konkurruese dhe detyrimet qe rrjedhin nga fitimi i proçedurës konkurruese.

Shpenzimet e kryera per te marre pjese ne proçedurën konkurruese nuk rimbursohen nga Autoriteti Kontraktues.

Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumenta ligjorë dhe administrative origjinalë ose kopje te noterizuara, si provë e kërkesave kualifikuese të percaktuara në dokumentat e proçedurës konkurruese dhe te dërgohen tek Ministria e Puneve Publike dhe Transportit, ne adresen: Sheshi “Skënderbej”, nr. 3, Tirane, Shqipëri.

Sigurimi i ofertes, qe eshte në shumën prej 2 % te vleres se projektit, të dorëzohet së bashku me oferten. Format e pranueshme të sigurimit janë përshkruar në dokumentat e proçedurës konkurruese.

Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në proçeduren e konkurimit në bazë të shtetësisë.

Per me shume informacion

www.app.gov.al